

Universiteti i Gjirokastrës ka qenë një ndër stacionet më të rëndësishme në të cilat është ndalur ambasadori i BE-së Luigi Soreca, i shoqëruar nga ambasadori austriak, gjatë vizitës së tij në Gjirokastrë, në kuadër të aktiviteteve të organizuara për Javët e Evropës.



Ambasadori Soreca është mirëpritur nga rektori i UGJ prof.dr. Bektash Mema dhe zv/rektorja prof.asoc. Valbona Duri. Në fjalën e mirëseardhjes rektori Mema bëri një panoramim të rezultateve pozitive që ka patur ky institucion falë zbatimit të projekteve të BE – së dhe bashkëpunimeve ndër vite të Universitetit të Gjirokastrës me universitetet evropiane.



“Projektet e BE janë prej shumë vitesh pjesë e Universitetit të Gjirokastrës duke sjellë ndryshime pozitive në institucionin tonë. Projektet Erasmus që do t’i cilësoja si epokën Erasmus, janë një projekt i shkëlqyer që u ka shërbyer studentëve dhe pedagogëve në rritjen e tyre profesionale. Kudo në universitet shih gjurmët e këtij bashkëpunimi me disa laboratorë bashkëkohorë, salla apo qendra studimore. Këto projekte po ndikojnë në afërsinë mes universitetit me qytetin dhe rajonin, pasi universiteti është një pasuri jo vetëm për qytetin, por për të gjithë rajonin. Kemi besim se bashkëpunimi ynë do të vazhdojë. Do të donim mbështetjen e BE –së për gjithçka që i duhet më shumë universitetit”, u shpreh rektori Mema.



Vizita e ambasadorëve në UGJ ka vijuar në mjediset e universitetit ku ata kanë parë nga afër disa prej laboratorëve kryesorë të UGJ -së, të financuara me mbështetjen e BE-së si, sallat kompjuterike në shërbim të “Qendrës së të mësuarit gjatë gjithë jetës” pjesë e projektit TEAVET nga programet Erasmus +, apo laboratorin e infermierisë, një ndër laboratorët më të mirë, një projekt i mbështetur nga CCNURCA i Erasmus +, shumë i vlefshëm për zhvillimin e seminareve të infermierëve të ardhshëm.



“Të gjithë jemi ERASMUS” ka qenë motoja e takimit me studentët e universitetit që shënoi edhe pikën kulmore të kësaj vizite. Studentët pjesëmarrës ndanë eksperiencën e tyre gjatë mësimnxënies në universitetet evropiane. Ata theksuan se përveç përfitimeve profesionale dhe sociale, duke krijuar kontakte të reja me bashkëstudentët të universiteteve pritëse dhe mënyra të reja komunikimi, kjo eksperiencë ka qenë para së gjithash një përvojë jetësore, pasi të rinjve u është dashur të përballen me vështirësitë e përshtatjes në një vend të huaj, pas daljes nga zona e mëparshme e "rehatisë".



Pjesëmarrës të stafit akademik që kanë qenë pjesë e praktikave Erasmus+ u shprehën për mundësitë pozitive në rritjen profesionale të tyre, por edhe të vetë kapaciteteve të universitetit.

Në mbyllje Ambasadori Soreca vuri theksin në rëndësinë e të mësuarit. Ai u shpreh se të rinjtë shqiptarë duhet të ndihen po aq evropianë sa çdo i ri në Evropë dhe “shumë shpejt do të jeni të tillë edhe zyrtarisht” theksoi ai, duke dhënë dritën jeshile përpjekjeve shekullore të shqiptarëve për integrimin në Bashkimin Evropian.





